# Plan 18

Në konkluzionet e miratuara të Këshillit të BE-së më 26.06.2018, dhe të konfirmuara nga Këshilli Evropian më 28.06.2018 është theksuar rëndësia e vazhdimit të progresit në zbatimin e Reformave Urgjente të Prioriteteve dhe dhënien e rezultateve të qëndrueshme shtesë në fushat e: gjyqësorit, sigurisë dhe shërbimeve të kundërzbulimit, reformës së administratës publike dhe luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, në mënyrë që të ruhet momenti i reformës që do të ndiqet nga afër nga Komisioni Evropian. Përparimi në këto fusha do të pasqyrohet në Raportin e rregullt vjetor të KE-së dhe do të ketë ndikim edhe në vendimin për përcaktimin e datës për fillimin e negociatave për anëtarësim në BE.

Plani është i ndarë në katër fusha kryesore të reformës, në përputhje me konkluzionet e Këshillit të BE-së.

Në fillim, është sqaruar fokusi i aktiviteteve të propozuara, lidhur me qëllimet përkatëse, të cilat pritet
të realizohen jo më vonë se në muajin shkurt të vitit 2019.

Për secilën prej aktiviteteve, parashikohet tregues adekuat, institucione përgjegjëse dhe institucione pjesëmarrëse

Sekretariati për Çështje Evropiane do të vazhdojë të monitorojë realizimin e prioriteteve afatshkurtra të parashikuara në NPAA, në përputhje me rekomandimet / vërejtjet e dhëna nga Komisioni Evropian në Raportin e rregullt vjetor

**Hyrje**

Plani 18 fokusohet në 4 fushat e reformave kryesore nga pjesa e sundimit të ligjit, në pajtim me konkluzat e Këshillit të BE-së, të miratuara në qershor të vitit 2018. Plani 18 është përgatitur në koordinim me ministritë resore, të cilat kanë kompetenca në këto fusha, dhe të njëjtat janë të konsultuara me sektorin civil dhe me komunitetin ndërkombëtar, ndërkaq janë marrë parasysh edhe rekomandimet e KE-së, konkluzat e Nënkomitetit të KSA-së, dhe një pjesë e rekomandimeve afatshkurtra nga misionet e realizuara të vlerësimit, si dhe rekomandimet e OSBE/ODIHR, Komisionit të Venedikut dhe GREKO-s.

Në fushën e jurisprudencës, fokusi është në:

o Implementimin e rekomandimeve të Komisionit të Venedikut për pakon e dytë të ndryshimeve dhe përgatitjen e pakos së tretë të ligjeve (për reforma të Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë)

o Zgjedhjen e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë sipas parimit meritor

o Rezultatet nga këqyrja për Sistemin AKMIS

o Avancimin e Legjislacionit për konteste administrative

o Avancimin e sferës penale dhe përgatitjen e strategjisë për menaxhim me burimet njerëzore në jurisprudencë.

Në pjesën e **reformave të shërbimeve të sigurisë** fokusi është në:

o Implementimin konsekuent të gjithë pakos së masave, të cilat kanë të bëjnë me funksionalizim të plotë të ATO-së (Agjencisë Teknike Operative) përmes miratimit të ligjeve të ngelura, sjelljes së akteve nënligjore

o Formimin e Këshillit për Mbikëqyrje Civile

o Reformën e plotë të Shërbimeve të Zbulimit me miratimin e Planit për reformë të Sektorit të Sigurisë – Zbulimit

Në pjesën e **reformave të administratës publike** fokusi është në:

o Depolitizimin e administratës publike – respektimin e parimit të meritave dhe ndërprerje të praktikës për punësime të përkohshme

o Përgatitjen e konceptit për sjellje të kategorisë së nëpunësve të lartë shtetërorë

o Përgatitjen e Plan veprimit për riorganizim/optimizim të organeve të administratës shtetërore, agjencive dhe shërbimeve të inspektimit në nivel qendror.

Në pjesën e reformave të **Politikave antikorruptuese** fokusi është në:

o Sjelljen e ligjit të ri për parandalim të korrupsionit, përfshirë edhe modelin e ri të KSHPK-së (Komisionit Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit) me kompetenca të përforcuara dhe funksionim përkatës

o Përforcimin e hetimeve financiare dhe konfiskimin e pronës

o Implementimin e rekomandimeve të GREKO-s për raundin e katërt të evalvimit dhe përgaditjen për raundin e pestë.

## 1. Reforma në gjyqësor

**Fokusi do të vihet në zbatimin e Strategjisë së reformave në gjyqësor dhe masat e parashikuara në Planin aksionar që paraqesin udhërrëfyes përmes të cilit do të lëvizin reformat në sektorin gjyqësor, kthimi i besimit në institucionet, sigurimi i sigursië juridike etj.**

| Qëllimet dhe masat: | Afati: | Institucioni bartës: | Institucione pjesëmarrëse: | Indikatorë | Statusi: | Koment: |
|---|---|---|---|---|---|---|
| TË ZBATOHEN DOKUMENTET STRATEGJIKE | | | | | | Lidhje me IPA 2014 EuropeAid/H/MK Support to justice and Reform Proces |
| 1.1.1. Përgatitja e raportit për monitorimin e Strategjisë për reforma në sektorin gjyqësor | 2/2019 | MD | AGJPP, GJS, PPRM, KGJRM | Raporti i përgatitur | | Lidhje me RRP; Rekomandime të Raportit të KE; lidhje me IPA 2014 EuropeAid/139374/IH/MK Support to Justice and Reform Process |
| 1.1.2. Përgatitja e Planit për monitorimin dhe zbatimin e Strategjisë së TKI për gjyqësorin | 2/2019 | MD | AGJPP, GJS, PPRM, KGJRM | Raporti i përgatitur | | Lidhje me RRP; Rekomandime të Raportit të KE; lidhje me IPA 2014 EuropeAid/139374/IH/MK Support to Justice and Reform Process |
| 1.1.3. Përgatitja e planit aksionar për zbatimin e Strategjisë sëTKI-së për gjyqëësorin | 12/2018 | MD | AGJPP, GJS, PPRM, KGJRM | Plani i përgatitur aksional | Është përgatitur Projekt-Plani Aksional me mbështetjen e ekspertëve përmes IPA 2014 FWC - "Preparation of Technical Specification for supply of ICT for the Justice Sector Institutions" - REQUEST No. IPA/AP2014/2.3JUS/LOT7/17. Trupi i centralizuar për TKI-në për sistemin e jurisprudencës (që duhet të formohet në pajtim me masën 1.4.4.) duhet ta finalizojë Planin Aksional. | Lidhje me RRP; Rekomandime të Raportit të KE; lidhje me IPA 2014 EuropeAid/139374/IH/MK Support to Justice and Reform Process |
| TË PËRFORCOHET PUNA E ORGANEVE UDHËHEQËSE | | | | | | |

| Qëllimet dhe masat: | Afati: | Institucioni bartës: | Institucione pjesëmarrëse: | Indikatorë | Statusi: | Koment: |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.2.1. Këshilli për zbatimin e reformave gjyqësore në mënyrë intenzive e ndjek reformën e gjyqësorit | 2/2019 | ZKQRM | MD | Mbledhje të mbajtura, përfundime të miratuara, mbi reformat e zbatuara; statusi i përfundimeve të realizuara | Janë mbajtur 6 mbledhje (procesverbalet janë të arritshme) | Në mbledhjet e Këshillit merren parasysh Raportet dhe rekomandimet nga misionet e vlerësimit për trajnim të gjykatësve dhe prokurorëve publikë dhe për drejtësi administrative. Këshilli luan rol të përforcuar dhe është promotor në realizimin e reformave të planifikuara. (lidhje me RRP, Raporte të KE; Pribe 1, Pribe 2) lidhje me IPA 2014 |
| 1.2.2.Akceptimi i Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykata | 2/2019 | QRM | MD | Ligji i akceptuar | Raporti i RVEN-së i publikuar në tetor, shqyrtimi i Këshillit për reformat në sektorin e jurisprudencës dhe mendimi për institucionet kompetente – tetor 2018; Komisioni i Venecias – tetor 2018; u mbajt debati publik më 01.11.2018. Debati i ardhshëm publik u caktua më 08-09.11.2018. | Ridefinimi i kushteve për zgjedhje të gjykatësve në gjykatën themelore dhe më të lartë, ridefinimi i bazave për shkarkimin e gjykatësit nga funksioni gjyqësor vetëm për shkelje më të rënda, futje të kategorisë gjykatës të rinj për periudhë dy vjeçare. Afatet janë harmonizuar me azhurnimin e afasteve në Plan veprimin nga Strategjia për reforma në sektorin e jurisprudencës (2017-2022). Mendimi i Komisionit të |
| 1.2.3. Miratimi i Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të gjykatave | 2/2019 | KRM | | Ligji i miratuar | | Nevojitet 2/3 e shumicës në KRM |
| 1.2.4. Akceptim i ndryshimeve të Ligjit për këshillin gjyqësor | 2/2019 | QRM | | Ligji i akceptuar | Raporti i RVEN-së i publikuar në tetor. Shqyrtimi i Këshillit për reformat në sistemin e jurisprudencës në nëntor 2018. Debati publik më 08 - 09.11.2018; | të këshillit gjyqësor nga radha e gjykatësve më me eksperienë të cilët më së paku e përmbushin kushtin për kryerje të funksionit në gjykatën e apelit; Deprofesionalizimi i punës së anëtarëve të Këshillit Gjyqësor në Këshillin. Afatet janë harmonizuar me azhurnimin e afateve në Plan veprimin e Strategjisë për reforma në sektorin e jurisprudencës (2017-2022). Mendimi i Komisionit të Venecias për ndryshimet e Ligjit për gjykatës nga tetori 2018, do të inkorporohet në pakon e re të |

| Qëllimet dhe masat: | Afati: | Institucioni bartës: | Institucione pjesëmarrëse: | Indikatorë | Statusi: | Koment: |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.2.5. Miratimi i ndryshimeve të Ligjit për Këshillin gjyqësor | 12/2018 | KRM | | Ligji i miratuar | | |
| 1.2.4 Akceptim i ndryshimeve të ligjit për Këshillit për prokurorë publikë | 11/2018 | QRM | | Ligji i akceptuar | Në rrjedhë është përgatitja e Ligjit për Këshillin e PP-së së RM-së. | Ndryshimet janë në drejtim të deprofesionalizimit të anëtarëve të Këshillit të PP të RM. Afatet janë harmonizuar me azhurnimin e afateve në Plan veprimin e |
| 1.2.5 Miratimi i ndryshimeve të Ligjit për Këshillin e prokurorëve publik | 12/2018 | KRM | | Ligji i miratuar | | |
| TË FORCOHET PAVARËSIA DHE PAANSHMËRIA NË GJYQËSOR | | | | | | |
| 1.3.1. Miratimi i një Plani për mbikqyrjen e vazhdueshme në gjykata për zbatimin e ACMIS në përputhje me ligjin për gjykatat | 12/2018 | MD | | Plan i përgaditur dhe i miratuar | Kompetenca e Ministrisë së Drejtësisë për inspektimet e rregullta në funksionimin e sistemit AKMIS ishte futur me ndryshimet e Ligjit për gjykata nga maji 2018, këto do të zbatohen nga janari 2019. Në pajtim me dispozitat ligjore, Ministria e Drejtësisë duhet të hartojë plan për inspektimin e rregullt në funksionimin e AKMIS-it nëpër gjykata dhe të formojë komision i cili nga janari 2019 do të fillojë me punë. | Pas përfundimit të këqyrjes së parë të funksionimit sistemit AKMIS të realizuar në Gjykatën themelore Shkup1, Gjykata e apelit Shkup dhe Gjykata supreme për të cilën u përgatit Raporti dhe i dorëzuar në Prokurorinë publike dhe Këshillin Gjyqësor, në mënyrë plotësuese u bë këqyrje edhe në GJTH Tetovë, GJTH Gostivar, GJA Gostivar, GJTH Shtip, GJA Shtip, GJTH Veles, GJTH Kumanovë. |
| 1.3.2. Përgatitja e një raporti përmbledhës gjysmëvjetor nga mbikëqyrja e rregullt e kryer në gjykata për aplikimin e ACMIS | 7/2019 | QRM | | Raporti përmbledhës gjysmëvjetor i përgaditur | | Raporti përgatitet për çdo mbikëqyrje të kryer të rregullt. Raporti përmbledhës gjysmëvjetor do t'i përfshijë raportet e veçanta nga çdo mbikëqyrje e rregullt e kryer. Nga janari deri në janar 2019 do të realizohet mbikëqyrje sipas |
| 1.3.3. Miratim i ndryshimeve të Ligjit për prokurori publike | 2/2019 | KRM | | Ligji imiratuar | Në rrjedhë është përgatitja e Ligjit për Prokurorinë Publike. | Revidimi i dispozitave që kanë të bëjnë me kushtet për zgjedhje të prokurorëve publikë, harmonizimin e dispozitave për përgjegjësi |

| Qëllimet dhe masat: | Afati: | Institucioni bartës: | Institucione pjesëmarrëse: | Indikatorë | Statusi: | Koment: |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.3.3. Akceptim i ndryshimeve në Ligjin për menaxhim me lëvizjen e lëndëve në gjykata | 5/2019 | QRM | | Ligji i akceptuar | | Nevojitet 2/3 e shumicës në KRM |
| 1.3.4. Miratim i ndryshimeve në Ligjin për menaxhim me lëvizjen e lëndëve në gjykata | 9/2019 | KRM | | Ligji i miratuar | | Ndryshimet janë në drejtim të tejkalimit të mundësive për keqpërdorimet e sistemit për ndarje elektronike të lëndëve |
| TË AVANCOHET CILËSIA NË DREJTËSI | | | | | | |
| 1.4.1. Akceptim i ndryshimeve të Ligjit për konteste administrative | 11/2018 | QRM | | Ligji i akceptuar | I publikuar në RVEN më 05.09.2018. Komentet e pranuara vetëm nga Gjykata Administrative. Në korrik dhe gusht është hartuar analiza funksionale dhe krahasuese e gjyqësisë administrative, e cila ishte shfrytëzuar gjatë përkufizimit të zgjidhjeve të propozuara ligjore, së bashku me komentet e Gjykatës | |
| 1.4.2. Miratimi ndryshimeve të Ligjit për konteste administrative | 2/2019 | KRM | | Ligji i miratuar | | Rritja e efikasitetit të kontestit administrativ, zvogëlim të gjatësisë së mbrojtjes administrative-gjyqësore. Afatet janë harmonizuar me azhurnimin e afateve në Plan-veprimin nga Strategjia për reforma në sektorin e jurisprudencës (2017-2022). KPE koment: të shtohen rekomandimet nga misioni i vlerësimit për procedurën administrative dhe kontestet administrative;<br>(lidhje me Raportet e KE - qasje e re; Pribe1, Pribe2) |
| 1.4.3. Fillim i procesit të vendosjes së sistemit për menaxhim me lëndë në gjyqësor, në sistemin penetenciar, për zbatimin e Strategjisë së TKI në gjyqësor, përmes prokurimit të pajisjeve TKI | 2/2019 | MD | AGJPP, GJS, PPRM, KGJRM | Prokurues - Supply of Integrated Court Case Management System; Supply of Integrated Penitentiary Management System | Më 16.11.2018 skadon afati për dorëzimin e ofertave dhe evalvimi duhet të zbatohet deri në fund të nëntorit 2018. | Ndryshimet e ligjit do t'i marrin parasysh rekomandimet dhe konkluzat nga misioni i vlerësimit për drejtësinë administrative |

| Qëllimet dhe masat: | Afati: | Institucioni bartës: | Institucione pjesëmarrëse: | Indikatorë | Statusi: | Koment: |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.4.4. Formimi i një trupi të centralizuar për TKI për sistemin gjyqësor (në përputhje me vërejtjet e KE-së) | 12/2018 | MD | AGJPP, GJS, PPRM, KGJRM | Organ i formuar për TKI për sistemin gjyqësor | Më 05.09.2018, MD-ja dorëzoi kërkesa në KGJRM, PSPRM, PPRM, GJSRM, AGJPP, DZS, për nominimin e anëtarëve. Përfundimisht me 01.11.2018 të gjitha institucionet kanë dorëzuar nominime, përveç Gjykatës Supreme. | Projekti IPA 2014 për furnizim të pajisjes TIK për institucionet e jurisprudencës Marrëveshja pritet të lidhet deri më 23.12.2018, në kohëzgjatje prej dy vitesh, që varet nga miratimi ex ante i DBE. (lidhje me Raportet e KE - qasje e re; Pribe1, Pribe 2) TAIB 2013 12-7440 LOTs1-8 Supply of Equipment for institutions in the area of justice and home affairs IPA 2014 Result 3/5 - Supply for Upgrade of ICT infrastructure, interconnection of relevant justice sector institutions, E-service and databases/develop of the ICT in the penitentiary and probation system |
| 1.4.5. Akceptim i Ligjit për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për procedurë penale | 4/2019 | QRM | MD | Ligji i akceptuar | Faza finale e hartimit. | Formimi i këtij trupi është një prej masave të parapara në Strategjinë për TIK në jurisprudencë. (lidhja me Raportet e KE - qasje e re; Pribe 1, Pribe 2) |

| Qëllimet dhe masat: | Afati: | Institucioni bartës: | Institucione pjesëmarrëse: | Indikatorë | Statusi: | Koment: |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.4.6. Miratim i Ligjit për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për procedurë penale | 5/2019 | KRM | MD | Ligji i miratuar | | Harmonizimi me standardet ndërkombëtare për të drejtat procedurale dhe atë direktivat e BE lidhur me të drejtën e interpretimit dhe përkthimit në procedurën penale, të drejtat e viktimës, si dhe mbrojtja e të dhënave personale në kuadër të bashkëpunimit në lëndët ndëshkimore. Afatet janë harmonizuar me azhurnimin e afateve në Plan veprimin e Strategjisë për reformë në sektorin e jurisprudencës (2017-2022). (lidhje me Raportet e KE - qasje e re) |
| 1.4.7. Akceptim i ndryshimeve në Kodin penal | 11/2018 | QRM | MD | Ligji i akceptuar | | Nevojitet 2/3 e shumicës në KRM |

| Qëllimet dhe masat: | Afati: | Institucioni bartës: | Institucione pjesëmarrëse: | Indikatorë | Statusi: | Koment: |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.4.8. Miratim i ndryshimeve në Kodin penal | 12/2018 | KRM | MD | Ligji i miratuar | | Revidimi i dispozitave në disa sfera, nga të cilat si më të rëndësishme janë: krimi nga urrejtja, mosndëshkimi i viktimës nga trafikimi me njerëz dhe mosndëshkimi fëmijë-viktimë, futja e veprës së re penale "Pengimi i drejtësisë", kodifikimi i veprës penale për mbrojtje të dëshmitarëve të përfshirë në Ligjin për mbrojtje të dëshmitarëve në Kodin Penal etj. Qëllimi kryesor është që të ngrihet dukshmëria e veprave të urrejtjes me përcaktim të definicionit ligjor të atij nocioni dhe parashikim të formave të veçanta të veprave të urrejtjes në Pjesën e veçanët, që  në pajtim me parimin e legalitetit do t'i obligojë organet e ndjekjes t'i zbulojnë, përcaktojnë dhe procesuojnë veprat e tilla.<br>(lidhje me Raportet e KE - qasje e re) |
| 1.4.9. Akceptim на i Ligjit për mbështetje juridike falas | 11/2018 | QRM | MD | Ligji i akceptuar | | Nevojitet 2/3 e shumicës në KRM |
| 1.4.10.  Miratim i Ligjit për mbështetje juridike falas | 2/2019 | KRM | MD | Ligji i miratuar | | Dhënie të mundësisë për numër sa më të madh të njerëzve për qasje |
| TË PËRMIRËSOHET EFIKASITETI NË GJYQËSOR/PËRFORCIMIN E KAPACITETIT TË GJYAËSORIT | | | | | | |

| Qëllimet dhe masat: | Afati: | Institucioni bartës: | Institucione pjesëmarrëse: | Indikatorë | Statusi: | Koment: |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.5.1. Mbledhja e të dhënave, statistikave dhe raporteve për gjyqësorin | 11/2018 | MD | KGJRM; KPPRM | Të dhëna,statistika dhe raporte të mbledhura | | |
| 1.5.2. Analizë e rrjetit gjyqësor | 12/2018 | MD | KGJRM; KPPRM; AGJPP | Analiza e përgatitur | | Masa zbatohet në drejtim të përgatitjes së analizës bazuar në dëshmi për nevojat e përgatitjes. Strategjia për menaxhim me resurse njerëzore në gjyqësor (lidhje me Raportet e KE dhe analiza të Bankës Botërore) |
| 1.5.3. Mbledhja e të dhënave, statistikave dhe raporteve për Prokurorinë Publike | 2/2019 | KGJRM, PPRM | MD, MF | Të dhëna,statistika dhe raporte të mbledhura | | |
| 1.5.4. Analizë e rrjetit të Prokurorive | 4/2019 | MD | MF | Analizë e përgaditur | | Masa zbatohet në drejtim të përgatitjes së analizës bazuar në dëshmi për nevojat e përgatitjes. Strategjia për menaxhim me |
| 1.5.5. Përgadsitje e strategjisë për menazhim me resurset njerëzore në Gjyqësor-KGJRM, AGJPP | 12/2019 | AGJPP | MF, MSHIA, MD | Strategji e përgaditur | | |

| Qëllimet dhe masat: | Afati: | Institucioni bartës: | Institucione pjesëmarrëse: | Indikatorë | Statusi: | Koment: |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.5.6. Përgaditje e strategjisë për menazhim me resurset njerëzore në PP | 12/2019 | MD | KPPRM, AGJPP | Strategji e përgaditur | | Rekomandime nga Misioni i vlerësimit: Rekomandohet që të përpunohet dhe miratohet urgjentisht strategjia nacionale reale për resurse njerëzore në jurisprudencën dhe në bazë të të dhënave të besueshme, statistikës, nevojave dhe planifikimit, të mbështetura me resurse financiare dhe materiale. Afati dhe aktiviteti i ridefinuar janë harmonizuar me Konkluzën nga Nënkomiteti i 13-të për drejtësi dhe punë të brendshme.<br>(lidhje me co EuropeAId/139374/IH/SER/MK - Support to Justice Sector and Reform Process) |

| Qëllimet dhe masat: | Afati: | Institucioni bartës: | Institucione pjesëmarrëse: | Indikatorë | Statusi: | Koment: |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Përgatitja e strategjisë për menaxhim me resurse njerëzore në PP | 12/2019 | MD | PSPRM AGJPP | Strategji e përgaditur | | Rekomandime nga Misioni i vlerësimit: Rekomandohet që të përpunohet dhe miratohet urgjentisht strategjia nacionale reale për resurse njerëzore në PP dhe në bazë të të dhënave të besueshme, statistikës, nevojave dhe planifikimit, të mbështetura me resurse financiare dhe materiale. Afati dhe aktiviteti i ridefinuar janë harmonizuar me Konkluzën nga Nënkomiteti i 13-të për drejtësi dhe punë të brendshme(lidhje me EuropeAId/139374/IH/SER/MK - Support to Justice Sector and Reform Process) |
| 1.5.7. Përforcimi i kapaciteteve kadrovike të gjykatësve dhe PP me nëpunës gjyqësor dhe të prokurorisë publike | 12/2018 | KPPRM, AGJPPMD MF | | Janë realizuar punësime të reja dhe avancime të nëpunësve gjyqësorë dhe të prokurorisë publike në gjykatat dhe PP | | Planifikimi i afro 100 nëpunësve gjyqësorë. Pas miratimit të ndryshimeve të Ligjit për Shërbim gjyqësor, në fillim të muajit nëntor do të shpallen konkurse për punësim të nëpunësve gjyqësorë për të gjitha gjykatat. |
| 1.5.8. Përforcimi i kapaciteteve kadrovike të MD për mbështetje të koordinimit të reformës në jurisprudencë | 12/2018 | MD | MF | Janë realizuar punësime të reja dhe avancime të nëpunësve në MD | Është shpallur konkurs për 12 vende pune | Janë paraparë gjithsej 37 punësime për vitin 2018 dhe është marrë pëlqim nga MF |

| Qëllimet dhe masat: | Afati: | Institucioni bartës: | Institucione pjesëmarrëse: | Indikatorë | Statusi: | Koment: |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.5.9 Përforcim të kapaciteteve kadrovike të AGJPP | 2/2019 | AGJPP | MF MSHIA MD | Janë realizuar punësime të reja dhe avancime në AGJPP | Më 22.10.2018 u mbajt mbledhja konstitutive e Këshillit Drejtues të AGJPP-së. Në mbledhjen e mbajtur më 26.10.2018 miratoi vendim me të cilin caktohet ushtruesi i detyrës drejtor. Në mbledhjen e mbajtur më 22.10.2018 miratoi vendim për shpalljen e konkursit publik për zgjedhjen e drejtorit dhe zëvendësdrejtorit. Konkursi është publikuar më 24.10.2018. | Masa përmban disa nënmasa- formim të organeve administrative dhe udhëheqëse të AGJPP, programi për punë dhe procedura e regjistrimit të dëgjuesve të rinj (në pajtim me rekomandimet nga misioni i vlerësimit), përforcimi i kapaciteteve kadrovike dhe kushteve hapësinore dhe ngjashëm. |

**2. Reforma në shërbimet e sigurisë dhe kundërzbulimit**

**Fokusi do të vihet në zbatimin e aktiviteteve me qëllim të arritjes së tejkalimit të dobësive në sistemin aktual të ndjekjes së komunikimeve, si dhe zbatimi i Strategjisë kombëtare për luftën kundër terrorizmit dhe Strategjia për parandalim të ekstremizmit të dhunshëm. Njëkohësisht në pjesën e reformave të policisë, do të monitorohet procesi i nisur për vendosjen e një mekanizmi të jashtëm kontrollues të punës së policisë**

| | Afati: | Institucioni përgjegjës: | Institucione pjesëmarrëse: | Indikatorë: | Statusi i realizimit: | Koment: |
|---|---|---|---|---|---|---|
| TË VENDOSET NJË MODEL I RI KOMBËTAR PËR SISTEMIN E NDJEKJES SË KOMUNIKIMEVE | | | | | | |
| 2.1.1. Akceptim i Ligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për procedurë penale | | QRM | | Ligji i akceptuar | I miratuar nga ana e Qeverisë së RM 26.12.2017 | Me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurë penale futet instituti "urdhër i anonimizuar" me çka operon ATO; (lidhje me RRP, Pribe1, Pribe2) |
| 2.1.2. Miratim i Ligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për procedurë penale | 11/2018 | KRM | | Ligji i miratuar | I miratuar nga ana e KRM 30.10.3018 | I votuar me 2/3 e shumicës në KRM |
| TË MIRATOHET PAKOJA E LIGJEVE PËR VENDOSJE TË MEKANIZMIT TË JASHTËM KONTROLLUES MBI PUNËN E POLICISË | | | | | | |
| 2.2.1. Akceptim i Ligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për prokurori publike | 12/2017 | QRM | | Ligji i akceptuar | I miratuar nga ana e QRM 26.12.2017 | Në Prokurorinë publike themelore për përndjekje të krimit të organizuar dhe korrupsionin formohet Njësi e specializuar për hetim dhe përndjekje të veprave penale të kryera nga persona me autorizime dhe pjesëtarë policorë të policisë së burgut. Njësia ka shërbim të veçantë profesional dhe hetues të prokurorisë publike nga qendra hetimore në pajtim me këtë ligj. (lidhje me RRP, Raportet e KE, Pribe1, Pribe2) |
| 2.2.2. Miratim i Ligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për prokurori publike | 12/2018 | KRM | | Ligji i miratuar | I miratuar nga ana e KRM 30.10.3018 | I votuar me 2/3 e shumicës në KRM |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.2.3. Akceptim i Ligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për gjykata | 12/2017 | QRM | | Ligji i akceptuar | I miratuar nga ana e QRM 26.12.2017 | Ekzistimi i mekanizmave të pavarura, efikase dhe në kohë për kontroll të punës së policisë është kërkesë në pajtim me KEDNJ dhe të drejtën e tij precedante, si dhe në pajtim me konstatimet e Komitetit Evropian për parandalim të torturës (KPT), mendimi i Komisarit për të drejtat e njeriut të Këshillit të Evropës në lidhje me vendimmarrjen e pavarur dhe efikase për ankesat kundër policisë dhe standardet tjera ndërkombëtare, etj. Mekanizmat e tilla doemos duhet praktikisht dhe në mënyrë hierarkike të jenë të pavarura nga ato veprimi i të cilave është lëndë e hetimit, të hapura ndaj këqyrjes së opinionit dhe të mund të sjellin vendime obligative të drejta. “-vepra penale të kryera nga nëpunës policor, person i autorizuar zyrtar për siguri dhe kundërzbulim me autorizime policore, pjesëtarë të policisë financiare, me ligj persona të autorizuar të Drejtorisë Doganore që punojnë në zbulimin e veprave penale dhe persona të autorizuar të Ministrisë së Mbrojtjes që punojnë në zbulimin dhe hetimin e veprave penale ose pjesëtarë të policisë së burgut, gjatë kryerjes së veprimit zyrtar ose për vepër penale të kryer jashtë shërbimit me përdorim të kërcënimit serioz, forcës ose mjeteve për detyrim që si pasojë ka vdekje, lëndim të rëndë trupor, lëndim trupor, privim kundërligjor nga liria, torturë dhe veprim tjetër i ashpër jonjerëzor ose poshtërues dhe ndëshkim nëse me ligj është paraparë përndjekje penale sipas detyrës zyrtare.”. |
| 2.2.4. Miratim i Ligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për gjykata | 12/2018 | KRM | | Ligji i miratuar | I miratuar nga ana e KRM 30.10.3018 | I votuar me 2/3 e shumicës në KRM |
| **TË FORMOHET AGJENCIA TEKNIKE OPERATIVE (ATO)** | | | | | | |
| 2.3.1. Përfundim i procedurës për zgjedhje të Drejtorit të Agjencisë Teknike Operative (ATO) | 09/2018 | KRM | MPB | Zgjidhet drejtor i ATO-s | Drejtori i ATO është zgjedhur më 06.09.2018. Më 29.10.2018 në Kuvendin mbahet takim i Komisionit për Mbikëqyrje të Zbatimit të Masës së Veçantë Hetuese Ndjekje të Komunikimeve nga ana e MPB, DPF, DD dhe MB me drejtorin e ATO. | (Lidhje me Pribe1, Pribe2) |
| 2.3.2. Miratim i akteve të organizimit të brendshëm dhe sistematizimit të vendeve të punës në Agjencinë Teknike Operative | 11/2018 | ATO | | Aktet e organizimit të brendshëm dhe sistematizimit të vendeve të punës në Agjencinë teknike-operative janë përgatitur dhe miratuar | Drejtori i ATO-së në tetor 2018 e miratoi Aktin për organizimin e brendshëm të ATO-së dhe Aktin për sistematizimin e vendeve të punës në ATO | |
| 2.3.3. Fillim i procedurës për punësim të personalit në ATO | 11/2018 | ATO | | Janë realizuar punësime në ATO | | |
| 2.3.4. Miratim i akteve nënligjore në bazë të LATO | 11/2018 | ATO | | Aktet nënligjore në bazë të LATO janë përgatitur dhe miratuar | Akte të miratuara | për sistematizimin e vendeve të punës, akt për organizim të brendshëm, rregullore për mënyrën e punës së ATO, rregullore për legjitimacionin zyrtar. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.3.5. Miratim i akteve nënligjore në bazë të LNK | 11/2018 | ATO | | Aktet nënligjore në bazë të LNK janë përgatitur dhe miratuar | Janë miratuar të gjitha aktet përveç aktit për mënyrën e ndjekjes së komunikimeve me ndihmën e pajisjeve teknike nëse zbatohet pa ndërmjetësimin e ATO-së dhe operatorët në kompetencë të PPRM-së. Akti i theksuar nënligjor është hartuar, dorëzuar në ekspertin e angazhuar nga KE-ja, pritet mendimi i tij | Mënyra e punës së operatorëve, anonimizimi i urdhrit i cili ka të bëjë me procedurën për siguri, për mënyrën e ndjekjes së komunikimeve me ndihmë të rregulloreve teknike dhe pajisjes nëse zbatohet pa ndërmjetësim të ATO dhe operatorëve, për mënyrën e rregullimit të rëndësisë së të dhënave në lidhje me anulimin e tyre. |
| 2.3.6. Miratim i akteve nënligjore në bazë të LPP | 11/2018 | MD | MPB | Aktet nënligjore në bazë të LPP janë përgatitur dhe miratuar | Akte të miratuara | Për anonimizimin e urdhrit kur ka zbatim të masës së veçantë hetuese ndjekje të komunikimeve |
| 2.3.7. Formim i Këshillit për monitorim civil në pajtim me Ligjin e ATO-s | 12/2018 | KRM | | Këshilli për monitorim civil është formuar | Kuvendi miratoi Vendim për shpallje të konkursit më 18.10.2018. Vendimi është shpallur në GZ numër 193 më 22.10.2018. Afati i aplikimit - 15 ditë. | |
